



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
Nr. 01-111/01-18877

Datë: 22.07.2022

Duke u bazuar në nenin 79, 80 dhe 82 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, Komuna e Gjakovës bën:

SHPLLJE TË KONKURSIT
Nëpunës Administrativ dhe Mbështetës

Nr.	Vendi i punës	Titulli i pozitës	Koeficienti	Statusi
1.	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)	Një (1) Shtëpiak (<i>shërbime teknike</i>)	4.8	Vend i lirë
2.	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)	Dy (2) Vozitës (<i>shofer</i>)	4.0	Vend i lirë
3.	IP “Ganimete Tërbeshi”	Një (1) punëtor Tekniko-Shërbyes (<i>Serviuere</i>)	4.0	Vend i lirë
4.	SHMLM “Hysni Zajmi”	Një (1) punëtor Tekniko-Shërbyes (<i>Pastruese</i>)	4.0	Vend i lirë
5.	SHML Gjimnazi “Hajdar Dushi”	Dy (2) punëtor Tekniko-Shërbyes (<i>Pastruese</i>)	4.0	Vend i lirë

Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Detyrat dhe përgjegjësitë për pozitat numër 1 dhe 2:

Punët dhe detyrat e punës do të kryhen në bazë të përshkrimit të detyrave të punës **për secilën pozitë të shpallur**, të parapara sipas Rregullores mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të QKMF-së dhe ne dispozita tjera ligjore në fuqi.

Detyrat dhe përgjegjësitë për pozitat numër 3, 4 dhe 5:

Personeli shërbyes – teknik, ka për detyrë të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë që janë të përcaktuara në kontratën e punës dhe Rregulloren për Institucionet Edukative – Arsimore të Komunës së

Gjakovës numër 01-110/05-11032 të datës 05/05/2017, si dhe detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Shkollimi i kërkuar: Shkollimi i Mesëm (*kandidatët që aplikojnë për pozitën numër 2 duhet të kenë patent shofer të kategorisë B dhe përvojë në vozitje së paku 5 vite*)

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- b. Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- c. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore të noterizuara (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- d. Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- e. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- f. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore*).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Testimi me shkrim
- b. Intervistë

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

Afati për aplikim:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data **22.07.2022** deri me datë **05.08.2022** (ora 16:00).

Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në Qendrën e Informimit, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Pranimi apo të dërgohen me postë në këtë adresë: Komuna e Gjakovës, Rruga “UÇK” numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkojnë me rastin e intervistimit.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.